



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education Science, Technology and Innovation

Informatori për staf shkollor rreth zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

(E njohur si Konventa e Stambollit)

Prishtinë, 2023

**Informatori për staf shkollor rreth zbatimit
të Konventës së Këshillit të Evropës për
parandalimin dhe luftën kundër dhunës
ndaj grave dhe dhunës në familje**

(E njohur si Konventa e Stambollit)

Përmbajtja

| HYRJA

| I KONVENTA E STAMBOLLIT (INFORMACIONE BAZIKE)

| II CILAT JANË SHTYLLAT KRYESORE SI DETYRIME PËR SHTETET ZBATUESE TË KËSAJ KONVENTE?

| III ROLI I SHKOLLËS NË ZBATIMIN E KONVENTËS SË STAMBOLLIT

| PËRFUNDIMI

Hyrje

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur si Konventa e Stambollit, është traktati më i përparuar ndërkombëtar, i cili dhunën ndaj grave e njeh si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi.

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet tjera nënshkruese të Konventës, kanë obligim zbatimin e saj. Edhe Kosova, në tetor të vitit 2022 e ka ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe kështu është zotuar për zbatimin e kësaj konvente. Pas ratifikimit, Qeveria e Kosovës me institucionet e veta ka ndërmarrë veprime strategjike për zbatimin e saj dhe brenda tyre ka detyrim edhe sektori i arsimit.

Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë probleme serioze në Kosovë, siç janë në shumicën e vendeve të botës. Këto lloj dhunimesh shpesh janë të padëshiruara dhe të paligjshme dhe ndikojnë negativisht në shëndetin, mirëqenien dhe lirinë e grave.

Në Kosovë, ka pasur progres në ndalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në vitet e fundit, por problemi ende ekziston. Një nga arsyet për këtë është se shumica e rasteve nuk raportohen, kështu që statistikave zyrtare nuk janë të sakta. Megjithatë, institucionet qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile kanë ngritur ndjekjen e rasteve të dhunës dhe kanë bërë përpjekje për të ofruar mbështetje dhe ndihmë për gratë që kanë qenë viktime të dhunës.

Në Kosovë, ka pasur edhe raste të njohura publikisht të dhunës ndaj grave, si dhe kritika të organizatave të shoqërisë civile dhe të drejtave të njeriut për mungesën e reagimit të menjëhershëm nga autoritetet qeveritare. Ndërsa ka pasur disa përpjekje për të ndryshuar kulturën patriarkale dhe për të promovuar barazinë gjinore, ende ka shumë punë për të bërë në këtë drejtim.

Në përgjithësi, dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë sfida serioze për Kosovën dhe për shoqëritë në të gjithë botën. Është e rëndësishme që institucionet dhe shoqëria civile të vazhdojnë të punojnë së bashku për të parandaluar dhe luftuar këto lloj dhune dhe për të ofruar mbështetje dhe ndihmë për viktimat.

Sektori arsimor ka rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje me rrezikun dhe pasojat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në promovimin e barazisë gjinore dhe respektit ndaj të drejtave të grave.

Kështu në linjë me veprimet e MASHTI-t, kjo broshurë është informuese për stafin e institucioneve edukative dhe arsimore, për përmbajtjen e Konventës së Stambollit dhe rolin e sektorit të arsimit/shkollës në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa.

Pa marrë parasysh ku ndodh dhuna, ajo paraqet shqetësim për shkollën dhe mjedisin, prandaj shkolla ka rol esencial në krijimin e mjedisit miqësor, njerëzor dhe të sigurt për komunitetin e saj, duke krijuar favore në arritjen e rezultateve që i pretendon secila shkollë.

(Ky informator u zhvillua nga stafi i MASHTI, duke marrë parasysh edhe materialet e Këshillit të Evropës)

I KONVENTAE STAMBOLLIT (INFORMACIONE BAZIKE)

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (në anglisht "The Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence") është miratuar në vitin 2011 dhe është traktati më i përparuar ndërkombëtar për të trajtuar shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, si dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave.

Qëllimi i kësaj konvente është të parandalojë dhe të luftojë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në të gjitha format e tyre. Ajo kërkon njohjen e dhunës ndaj grave si një problem të rëndë shoqëror dhe kërkon që shtetet anëtare të marrin masat e nevojshme për parandalimin, luftimin dhe dënimin e këtij fenomeni.

Parandalimi i dhunës, mbrojtja e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve janë elementet esenciale të kësaj konvente.

Disa nga pikat kryesore të kësaj konvente janë:

- Përcaktimi i dhunës ndaj grave si një shkelje e të drejtave të njeriut dhe e barazisë gjinore;
- Kriminalizimi i veprave si: gjymtimin gjinor, martesën e detyruar, përndjekjen, abortin dhe sterilizimin e detyruar. Kjo do të thotë që shtetet do të detyrohen, për herë të parë të përfshijnë këto vepra penale në sistemet e tyre ligjore;
- Identifikimi i masave për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, duke përfshirë masat e ndërmarra nga institucionet publike dhe shoqëria civile;
- Sigurimi i mbështetjes dhe shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës, duke përfshirë strehimin e sigurt, kujdesin mjekësor dhe këshillimin;
- Përcaktimi i masave të nevojshme për të ndaluar ushtrimin e dhunës ndaj grave nga personat e autorizuar ose në pozicione të fuqishme në shoqëri;

● Konventa u kërkon shteteve anëtare që të marrin masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe të raportojnë për progresin e tyre në zbatimin e saj.

Konventa është një instrument i rëndësishëm në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Evropë dhe në të gjithë botën.

Konventa mbron të gjitha gratë dhe vajzat, pavarësisht nga mosha, raca, feja, origjina sociale, statusi i migrimin apo orientimi seksual. Konventa njihet se ka grupe grash dhe vajzash të cilat shpesh janë në rrezik më të madh për të përjetuar dhunë dhe si rrjedhojë shtetet duhet të garantojnë dhe marrin parasysh nevojat e tyre specifike. Po ashtu, shtetet inkurajohen të zbatojnë konventën dhe për viktimat të tjera të dhunës në familje, si: burrat, fëmijët dhe të moshuarit.

II CILAT JANË SHTYLLAT KRYESORE SI DETYRIME PËR SHTETET ZBATUESE TË KËSAJ KONVENTE?

◆ PARANDALIMI

Te kjo shtyllë secili shtet duhet të ketë në fokus çështjet si në vijim:

- Ndryshimin e sjelljeve, roleve dhe stereotipeve gjinore që e bëjnë të pranueshme dhunën ndaj grave;
Trajnimin e profesionistëve që punojnë me viktimat;
- Rritjen e ndërgjegjësimit për format e ndryshme të dhunës dhe për natyrën e tyre traumatizuese;
- Përfshirjen e çështjeve të barazisë gjinore në kurrikulat e të gjitha niveleve të arsimit;
- Bashkëpunimin me OJQ-të, median dhe sektorin privat për të ndërgjegjësuar publikun.

◆ MBROJTJA

Te mbrojtja duhet të punohet në:

Vendosjen e nevojave dhe sigurisë së viktimave në qendër të të gjitha politikave;

Krijimin e shërbimeve dhe strukturave të specializuara për dhënien e ndihmës mjekësore si dhe këshillimin psikologjik dhe ligjor të viktimave dhe fëmijëve të tyre;

Vënien në dispozicion të një numri të mjaftueshëm strehëzash si dhe të një linje telefonike 24-orëshe pa pagesë.


◆ NDJEKJA PENALE

Te ndjekja penale janë esenciale pikat si në vijim:

- Dhuna ndaj grave të konsiderohet si vepër penale dhe të dënohet sipas ligjit;
- Justifikimet në bazë të kulturës, zakoneve, fesë ose të ashtuquajturin “nder” të konsiderohen si të papranueshme për çdo akt dhune;
- Viktimave t'u sigurohen masa të posaçme mbrojtje gjatë hetimit dhe proceseve gjyqësore ;
- Institucionet e zbatimit të ligjit t'u përgjigjen menjëherë thirrjeve për ndihmë dhe të menaxhojnë në mënyrën më të përshtatshme situatat e rrezikshme.

◆ POLITIKA TË INTEGRUARA

- Këto shtete marrin veprime që të sigurojnë përfshirjen e të gjitha masave të mësipërme në një katalog të vetëm të politikave dhe të ofrojnë një përgjigje të përbashkët ndaj dhunës kundrejt grave dhe dhunës në familje.



III ROLI I SHKOLLËS NË ZBATIMIN E KONVENTËS SË STAMBOLLIT

Sipas këtyre shtyllave që i adreson konventa, sektori i arsimit ka detyrime në parandalim, mbrojtje dhe te politikat e integruara.

◆ Parandalimi

Mësimdhënësit dhe stafi tjetër i shkollës (sipas nenit 13 për ndërgjegjësimin dhe nenin 14 për arsimin) kontribuojnë në parandalim të dhunës gjatë procesit edukativo-arsimor si:

- Përmes kurrikulës (fushës Shoqëria dhe mjedisi);
- Çështjeve ndërkurrikulare të të gjitha fushave kurrikulare;
- Aktiviteteve jashtëkurrikulare (shënimin e ditëve të veçanta, ligjërata, debate, aktivitete artistike, fushata, aktivitete bashkëpunuese me institucione përgjegjëse si: Policia, QPS, OJQ, etj);
- Zhvillimit dhe përdorimit të materialeve ndërgjegjësuere përgjatë aktiviteteve mësimore;
- Etj.

◆ Mbrojtja në kontekst të shkollës

Stafi i shkollës e luan rolin mbrojtës kur ka vëmendje ndaj çdo shenje dhe predispozite të dhunës. Duhet konsideruar me seriozitet veprimet në vijim:

- Identifikimi i predispozitave të dhunës në familje të identifikueshme brenda komunitetit të shkollës;
- Raportimi dhe referimi i rasteve të dyshuara te shërbimet përgjegjëse;
- Vëmendje e shtuar për rastet e rehabilituara dhe të rikthyera në shkollë;
- Ruajtja e privatësisë së rasteve që i identifikon dhe i raporton;
- Aktivitet mbështetëse psikologjike për rastet e rikthyera në arsim.

Identifikimi i rasteve të fëmijëve/ nxënësve dhe të tjerëve brenda shkollës, që mund të jenë viktima të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në mjedise të ndryshme, është hap parandalues dhe mbrojtës për viktimat e mundshme.

Shenjat e mundshme identifikuese për fëmijë/ nxënës dhe të tjerë:

- Rënia e menjëhershme e suksesit në mësim/ punë;
- Mospërqendrimi në mësim/punë;
- Vështirësi në të mësuar/ në realizim të detyrave;
- Mungesat dhe vonesat e paarsyeshme në mësim/ punë;
- Ndryshimet në qëndrime;
- Sjellje antishoqërore;
- Mospranimi për bashkëveprim social;
- Shenja të dukshme të dhunës fizike (njolla/ hematoma, shenja të pagjumësisë, lodhjes, lëndime tjera fizike, etj.);
- Shenja ankthi, frike, stresi;
- Humbja e peshës;
- Shenja të tërheqjes dhe të izolimit;
- Të qenit agresiv ndaj të tjerëve;
- Vetëvlerësim i ulët, etj.

Këto janë disa nga shenjat e mundshme për identifikim, por jo domosdoshmërisht të gjithë ata (fëmijët/ nxënësit apo stafi tjetër i shkollës) që i kanë këto shenja mund të jenë pre e dhunës në familje. Gjithsesi fëmijët e të tjerët me këto shenja kanë probleme, por të natyrave të ndryshme sociale, familjare apo tjetër dhe kërkojnë trajtim adekuat ndërinstitucional.

Kur dyshohet për raste të tilla, shkolla ndërmer veprime intervenuese që nga faza e raportimit e tutje.

(Identifikimi, raportimi dhe referimi bëhet sipas procedurave standarde të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje). Raportimet në sistem SMIA te moduli i dhunës dhe te ai i paralajmërimit të braktisjes, sipas specifikave përkatëse dhe udhëzimeve, është detyrim ligjor.

Edukimi dhe arsimimi cilësor ka rol të fuqishëm në edukimin qytetar mbi konceptet e dhunës, dëmet dhe pasojat e saj, prandaj me nene të veçanta shihen detyrimet e institucioneve edukative dhe arsimore, sipas kësaj konvente.

Politikat e integruara

Roli i shkollës është shumë i rëndësishëm në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Shkolla është një vend ku fëmijët dhe të rinjtë marrin edukatën e tyre dhe është një vend ku mund të ndërtohen qëndrime pozitive ndaj respektimit të të drejtave dhe barazisë gjinore.

Në kuadër të politikave të integruara kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, shkollat duhet të krijojnë një ambient të sigurt dhe të mbrojtur për fëmijët dhe të rinjtë. Shkollat duhet të kenë politika dhe procedura të qarta për t'i trajtuar rastet e dhunës dhe abuzimit në familje dhe për t'i përcjellë dhe referuar ato.

Gjithashtu, shkollat duhet të ofrojnë edukim për të gjithë nxënësit në lidhje me të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe respektin ndaj njëritjetrit. Ky edukim mund të jepet nëpërmjet planit mësimor, aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore.



Në këtë drejtim, shkollat mund të ndërmarrin veprime të tilla si:

- Përfshirja e temave të barazisë gjinore dhe të të drejtave të njeriut në programin mësimor;
- Organizimi i aktiviteteve për të sensibilizuar nxënësit në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave;
- Organizimi i punëtorive dhe trajnimeve për mësuesit në lidhje me atë se si të identifikojnë dhe trajtojnë raste të dhunës dhe abuzimit në familje;
- Krijimi i grupeve të ndihmës dhe këshillimit për nxënësit që kanë përjetuar dhunë në familje;
- Bashkëpunimin me organizatat lokale të pranishme ndërkohë që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për viktimat të dhunës në familje;
- Etj.

Për të arritur qëllimet e politikave të integruara kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, është e rëndësishme që shkollat të bashkëpunojnë me komunitetin dhe të gjithë institucionet e tjera relevante, duke përfshirë institucionet qeveritare dhe organizatat joqeveritare.

Brenda shërbimeve të integruara hyjnë edhe masat që ndërmerr shkolla për fëmijët, nxënësit viktimat të dhunës në familje apo viktimat e dhunës me bazë gjinore, ndërkohë që ato marrin edhe shërbime tjera nga institucionet tjera përgjegjëse.



◆ PËRFUNDIM

Ky informator e ndihmon stafin e shkollës për të qenë brenda rolit të vet në parandalim dhe reagim ndaj dhunës në familje, konform kësaj konvente dhe legjislationit në fuqi. Duke qenë se fëmijët dhe të rinjtë e moshës shkollore e kalojnë kohën e gjatë brenda institucioneve edukative dhe arsimore, të cilat në bazë të evidencave të rregullta për fëmijët, nxënësit, në kontekst të institucionit, mund të identifikojnë shenjat e dhunës dhe kanë përgjegjësi institucionale për reagim dhe raportim.

Ndërkaq në anën tjetër, esenciale për fushëveprimin e sektorit edukativ dhe arsimor është krijimi dhe kultivimi i vlerave të edukimit qytetar, vlerave të paqes dhe demokracisë, ku përmes individëve si qytetarë të përgjegjshëm synon familjet dhe shoqërinë e shëndoshë. Kjo gjë, siç u tha në përmbajtjen e këtij informatori, arrihet nëpërmjet edukimit dhe arsimimit cilësor.

Ashtu siç tregon vetë konventa, sektori i arsimit është vetëm një nga hallkat e sistemit të mbrojtjes së viktimave, nëpërmjet të parandalimit të dhunës, raportimit të instancat përgjegjëse dhe trajtimit profesional të viktimave që janë brenda komunitetit të shkollës.

Fare në fund, puna cilësore e shkollave, përfshirë evidencat për veprimet e saj, tregon përkushtimin institucional dhe krijon favore në raportimet dhe planifikimet cilësore brenda hierarkisë shtetërore dhe në nivel ndërkombëtar.

Duke besuar në rolin e fuqishëm të institucioneve edukative dhe arsimore, si dhe në profesionalizimin e stafit të tyre, presim mobilizimin e duhur për zbatimin e konventës!

◆ Shtojcë:

- Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje
<https://rm.coe.int/168046246b>
- Ligji nr. 06/l-077 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës
<https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/1A14F1C9-FBBA-4B4F-AAF4-08BD94F39EC5.pdf>
- Ligji nr. 03/l-182 për mbrojtje nga dhuna në familje
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18420>
- Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë.
<https://readgur.com/doc/114429/procedurat-standarde-t%C3%AB-veprimit-p%C3%ABr-mbrojtje-nga-dhuna-n...>



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education Science, Technology and Innovation